

VENDIM
Nr.572, datë 27.7.2005

PËR DHËNIE FONDI KRYQIT TË KUQ SHQIPTAR PËR PROMOVIMIN E DHURIMIT
VULLNETAR TË GJAKUT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr.7864, datë 29.9.1994 “Për Kryqin e Kuq Shqiptar”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Kryqit të Kuq Shqiptar t’i jepet fondi prej 2 700 000 (dy milionë e shtatëqind mijë) lekësh, për promovimin e dhurimit vullnetar të gjakut.

2.Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2005 i Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut.

3.Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano